

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat e

Kosovës



RAPORTI I MISIONIT

mbi

2.2.1.1 Vazhdimi i rishikimit të llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu, Statistikat e Danimarkës

1-5 Shtator 2014

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	6
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	6
2.1 Rishikimi i llogarive vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve	6
2.2 Vlerësimi i BPV-së 2013 sipas qasjes së shpenzimeve.....	8
3. Konkluzionet dhe Rekomandimet	9
Aneksi 1. Termet e Referencës	Fejl!
Bogmærke er ikke defineret.	
Aneksi 2. Personat e takuar	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BoPs	Bilanci i Pagesave
BEC	Kategoritë e Mëdha Ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
SHKF	Shpenzimet e Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
FBKF	Formimi Bruto Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
IC	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informatike
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MOU	Memorandum i Mirëkuptimit
LLK	Llogartië Kombëtare

NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afat-Shkurta
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Misioni aktual, i realizuar në periudhën 1-5 Shtator të vitit 2014, nën komponentin e 2-të – Llogaritë Kombëtare të Projektit të Binjakëzimit, ka pasur si objektiva kryesore analizimin e implementimit të ESA 2010 në Llogaritë Kombëtare vjetore të Kosovës për periudhën 2008-2012, dhe përkrahja e ASK-së në vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013.

DLLK i ASK-së ka qenë i përfshirë në projektin multi-përfitues të IPA 2011 (Prill 2013-Qershor 2014) dhe ka pranuar përkrahje teknike prej FMN-së gjatë periudhës Qershor 2012-Korrik 2014. Në kuadër të kornizës së projektit IPA 2011, ASK-ja ka pasur dy objektiva kryesore: implementimin e ESA 2010 dhe fillimin e implementimit të llogarive kombëtare tremujore; asistenca teknike e FMN-së ka ofruar përkrahje në përmirësimin e llogarive kombëtare vjetore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante.

Aktiviteti për implementimin e ESA 2010 është fokusuar në vlerësimin e hulumtimit dhe zhvillimit (R&D) dhe sistemit të armëve; bazuar në përkrahjen teknike të FMN-së, janë implementuar kërkesat e ESA 2010 për vlerësimin e sigurimit jo-jetësor, FISIM dhe outputit të Bankës Qendrore.

Gjatë implementimit të ESA 2010, ka filluar rishikimi i të dhënave vjetore në kuadër të kornizës së projektit të FMN-së, për periudhën 2008-2012 në lidhjem e vlerësimet e: (i) outputit dhe konsumit të ndërmjetëm të njësive jo-financiare; (ii) outputit të qeverisë (përfshirë metodën e re për kalkulimin e SHKF-së), (iii) Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare (SHKFEF); (iv) qerasë së përlllogaritur dhe (v) vlerësimet e outputit të qeverisë në çmime konstante dhe taksave mbi produktet. Metoda e kalkulimit të SHKFEF-së ka ndërruar plotësisht, duke kaluar nga vlerësimi i bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomisë Familjare (ABEF) në qasjen e rrjedhës së mallrave.

Të dhënat e para të rishikuara për vitet 2008-2012 kanë qenë në dispozicion në fillim të misionit. Të dhënat nuk janë të finalizuara, të dhënat mbi BPV-në sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, nuk janë konsistente. Gjatë misionit, është bërë analiza e vlerësimeve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve dhe janë ofruar rekomandimet për përmirësime. Vlerësimet për vitin 2013 kanë filluar dhe rezultatet e para të formimit të bruto kapitalit fiks (FBKF), konsumit final të qeverisë (KFQ) dhe importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve në çmime aktuale dhe konstante kanë qenë në dispozicion në fund të misionit; vlerësimet e shpenzimeve të konsumit final të ekonomive familjare (SHKFEF) kanë përparuar mjaft, por nuk janë finalizuar. Ky aktivitet do të finalizohet javën e ardhshme, sepse është planifikuar që me 12 shtator të bëhet diseminimi i BPV-së së vitit 2013.

Procesi i rishikimit në tërësi dhe implementimit të ESA 2010 ka qenë detyrë mjaft e vështirë dhe analizimi i të dhënave ka vënë në pah disa mospërputhje. Përmirësimet, që janë bërë gjatë misionit për vitet 2012 dhe 2013 për qasjen e BPV-së sipas shpenzimeve, duhet të aplikohen edhe për vitet e mëparshme, në mënyrë që të sigurohet një konsistencë e serive kohore. BPV-ja sipas qasjes së prodhimit duhet të analizohet dhe rishikohet në mënyrë që të jetë koherente me anën e shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante. Ky rishikim duhet të finalizohet para fundit të Nëntorit, kur do të publikohet BPV-ja për vitin 2013 sipas qasjes së prodhimit.

1. Komente të përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Rishikimi i llogarive vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve për periudhën 2008-2012 bazuar në ESA 2010
- Përkrahje për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve bazuar në ESA 2010 për vitin 2013

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimet dhe rezultatet

2.1 Rishikimi i llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve

Gjatë misionit janë analizuar vlerësimet e para të rishikuara për BPV-në vjetore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve sipas ESA 2010.

a. BPV-ja sipas qasjes së prodhimit

Vlerësimet e BPV-së sipas qasjes së prodhimit kanë filluar në kuadër të kornizës IPA 2010, gjatë periudhës Prill 2011-Shtator 2012; BPV në çmime aktuale dhe konstante janë elaboruar për periudhën 2008-2011. Për kalkulimin e BPV-së për vitin 2012, ASK-ja ka pasur përkrahje teknike nga FMN-ja. Vitin e kaluar, FMN-ja ka propozuar metoda të reja të vlerësimit të outputit (O) dhe konsumit të ndërmjetëm (IC) bazuar në të dhënat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) dhe ka përkrahur ASK-në në realizimin e rishikimit të të dhënave për vitet 2008-2012.

Vlerësimet aktuale të outputit të njësive jo-financiare kanë dy probleme kryesore; njëri është i lidhur me cilësinë e ASN-së, që është burimi i vetëm i përdorur për kalkulimet, dhe problemi i dytë është fakti që ekonomia jo e vëzhguar nuk është marrë parasysh. Gjatë misionëve të

mëparshme në kuadër të projektit IPA, janë analizuar të dhënat nga ASN-ja dhe janë identifikuar probleme, duke filluar nga konsistenca e brendshme e pyetësorëve të plotësuar deri te klasifikimi i njësive sipas aktivitetit dhe korrelacioni me të dhënat e Administratës Tatimore. Përdorimi i këtyre të dhënave për vlerësimin e outputit ka ndikim të madh në cilësinë e rezultateve.

Analizimi i konsumit të ndërmjetëm ka vënë në pah mospërputhjen në periudha kohore. Pjesëmarrja e konsumit të ndërmjetëm në outputin e disa industrive dallon shumë nga viti në vit; për industri të tjera, pjesëmarrja është e njëjtë për pesë vite. Shkalla e rritjes së konsumit të ndërmjetëm për disa industri ka vlera të çuditshme, pa ndonjë shpjegim ekonomik.

Këto çështje janë diskutuar me stafin e DLLK-së dhe është rekomanduar të rishikohen kalkulimet për të përmirësuar konsistencën.

b. BPV sipas qasjes së shpenzimeve

Janë analizuar vlerësimet e rishikuara të BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe janë propozuar përmirësimet e nevojshme.

Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare (SHKFEF) për periudhën 2008-2012 janë rishikuar dhe vlerësimet e reja janë bazuar mbi qasjen e rrjedhës së mallrave. Në këtë aspekt, mangësitë që ekzistojnë në vlerësimet e outputit kanë ndikim në rezultatet e SHKFEF-së. Problemi i dytë është fakti që korrelacioni midis ofertës dhe përdorimit, që kërkohet nga kjo metodë, nuk është respektuar. Konsumi i ekonomive familjare është vlerësuar si diferencë midis outputit total të ekonomisë, plus importi për konsumin e ekonomive familjare minus konsumi total i ndërmjetëm i ekonomisë dhe minus eksporti. Këtyre vlerave ju janë shtuar marzha e tregtisë dhe TVSH-ja e ekonomisë totale. Pra, në kalkulime përdorimi i outputit për formimin e bruto kapitalit fiks, inventarit, konsumit final të qeverisë dhe institucionet jo-profitabile, që i shërbejnë ekonomive familjare (NPISH), nuk janë marrë në konsideratë.

Shifrat e rishikuara për formimin bruto të kapitalit fiks (FBKF) që ishin në dispozicion në fillim të misionit, nuk kanë marrë në konsideratë përmirësimet e rekomanduara gjatë misionit të fundit (shih raportin e misionit qershor 2014). Janë bërë kalkulime të reja janë përmirësuar seritë kohore të FBKF.

Është bërë edhe rishikimi i kalkulimit të konsumit të kapitalit fiks (KKF) të aseteve të qeverisë, inicuar nga FMN-ja. Metoda PIM është vënë në vend. Ka pasur dokumente në excel në dispozicion por pa ndonjë shpjegim metodologjik. Analizimi i këtyre dokumentave ka vënë në pah disa aspekte, që kanë të bëjnë me çmimet e përdorura. Ekspertët i kanë dorëzuar dokumentat për analizim Z. Timmi Graversen. Ai, në parim është pajtuar me kalkulimet e propozuara dhe ka konsideruar që në të ardhmen janë të nevojshëm përmirësimet e mëtejme, sidomos për vlerësimin e aksioneve kapitale dhe çmimeve të përdorura.

2.2 Vlerësimi i BPV-së për vitin 2013 sipas qasjes së shpenzimeve

Gjatë këtij misioni ka filluar vlerësimi i BPV-së për vitin 2013 sipas qasjes së shpenzimeve. Ekspertja ka ofruar përkrahje për vlerësimin e SHKFEF-së, FBKF-së në çmime aktuale dhe konstante dhe vlerësimin e import dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve, në çmime konstante.

Përmirësimet kryesore që janë bërë në vlerësimet e FBKF-së, janë bazuar në rekomandimet e ofruara gjatë misionit të qershorit të vitit 2014 dhe përfshijnë:

- Vlerësimin e mirëmbajtjes dhe riparimeve në ndërtimtari në mënyrë që ti eliminojë ato nga FBKF-ja
- Vlerësimin e konsumit të ndërmjetëm në ndërtimtari, bazuar në rezultatet e anketës së për implementimin e indeksit të kostos së ndërtimtarisë.
- Vlerësimin e riparimeve të mëdha për pajisje dhe makineri, si pjesë e FBKF-së
- Përfshirë hulumtimin dhe zhvillimin në FBKF, siç kërkohet nga ESA 2010.

Është përmirësuar vlerësimi i eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve në çmime konstante, për periudhën 2008-2013. Importi i mallrave në çmime konstante është vlerësuar bazuar në të dhënave nga dogana (ku, importi është vlerësuar bazuar në çmimet e CIF (kosto-sigurimi-mallrat)), por në kalkulimin e BPV-së është vlerësuar në FOB (free on board). Vlerësimet e reja janë bazuar në të dhënat e importit nga IÇIM dhe FOB. Importi i shërbimeve është vlerësuar bazuar në mesataren e IÇK-së nga Gjermania, Shqipëria dhe Maqedonia (partnerët kryesorë komercialë). Indekset janë aplikuar në secilin tip të shërbimeve të importuara. Për sa i përket eksporteve të shërbimeve, është aplikuar deflacioni në bazë të IÇK-së së brendshme korresponduese.

Për SHKFEF, metoda dhe kalkulimet e përdorura në bashkëpunim me këshilltarin e FMN-së nuk janë ndryshuar; ekspertja ka punuar në vlerësimin e rezultatit për vitin 2013, sipas NACE rev.1, në nivel 2 shifror duke ndjekur të njëjtën metodologji. Për ta mundësuar këtë, është realizuar një vlerësim i outputit dhe konsumit të ndërmjetëm për vitin 2013. Të dhënat nga Administrata Tatimore për qarkullimin dhe çmimet në dispozicion (IÇP dhe IÇK) janë përdorur për vlerësimet e outputit. Konsumi i ndërmjetëm është vlerësuar bazuar në pjesëmarrjen e IC/O nga të dhënat e vitit 2012.

Qeraja e përllogaritur për vitin 2013 është vlerësuar në bazë të vlerës së vitit 2011 (si standard, bazuar në të dhënat mbi banesat nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave) dhe IÇK-së përkatës, duke supozuar që shkalla e rritjes e përcjell shkallën e rritjes në ndërtimtari. Në fund të misionit u siguruan rezultatet e para; kalkulimet do të vazhdojnë javën e ardhshme në mënyrë që të mund të publikohen me 12 Shtator.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Gjatë misionit janë ofruar rekomandime të detajuara lidhur me vlerësimin e BPV-së vjetore sipas qasjes së shpenzimeve.

Rishikimi në tërësi i BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, për periudhën 2008-2012 ka qenë një detyrë e vështirë duke pasur parasysh kohën e shkurtër dhe burimet njerëzore, në dispozicion, në DLLK-së. Plani i hartuar gjatë misionit të fundit nuk është përmbushur dhe ekspertja ka pasur mundësi të shoh vlerësimet e reja vetëm në fillim të misionit aktual. Si detyrë kryesore ka qenë të vlerësohet BPV-ja e vitit 2013 sipas qasjes së shpenzimeve, ekspertja ka fokusuar aktivitetin e saj gjatë këtij misioni, kryesisht në këtë temë.

Rekomandimet kryesore, që janë ofruar gjatë misionit të fundit (Qershor 2014) janë implementuar për vlerësimin e BPV-së 2013 sipas qasjes së shpenzimeve; është e nevojshme të implementohen këto rekomandime për tërë periudhën 2008-2012, në mënyrë që të sigurohet konsistenca e serive kohore.

Objektivi i radhës i ASK-së është vlerësimi i BPV-së 2013 sipas qasjes së prodhimit dhe diseminimi i tij në fund të nëntorit të vitit 2014. Është rekomanduar të analizohen në thellësi vlerësimet e reja për periudhën 2008-2012 dhe të përmirësohen ato bazuar në mangësitë, që janë identifikuar dhe diskutuar me stafin e DLLK-së gjatë misionit. Ky rishikim duhet të finalizohet sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që të përdoren rezultatet për vlerësimin e BPV-së tremujore për periudhën e vitit 2010-2013.

Aneksi 1. Termat e Referencës**Projekti i Binjakëzimit i BE-së****KS12 IB ST 01****Përkrahje për Statistikat****Termat e Referencës:****Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare****Aktiviteti 2.2.1.1: Vazhdimi i rishikimit të llogarive vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve****Afatet:****Ter – data e finalizimit : 10 Korrik 2014****Fillimi / fund i aktivitetit: 1–5 Shtator 2014****Koha e raportimit: 12 Shtator 2014****Rezultatet obligative të komponentit:**

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.2.1.1	Rishikimi i llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve	- Raporti i Misionit, ku përshkruhet puna e realizuar dhe që duhet të realizohet para aktivitetit të radhës, i publikuar në web faqen e projektit - Llogaritë kombëtare vjetore, të rishikuara	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raportet e Misionit - Plani veprues i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm - Absorbimi - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në statistika primare të qarta - Termet e referencës, të përpiluara me

				kohë, që paraqesin në detaje detyrat, aktivitetet, rezultat e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	--

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.2.1.1

Ky mision është vazhdim i misionit 2.2.1.

Konsultime dhe diskutime të mëtejme me njësinë e Llogarive Kombëtare.

Harta rrugore për Llogaritë Kombëtare, e paraqitur në tabelën nr.2, në raportin e misionit 2.1.1 (Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të Veprimit) nga Graversen dhe Ungureanu, paraqet në detaje hapat që duhet të ndërmerren për realizimin e këtij plani. Plani i punës, i hartuar vitin e kaluar nga ASK-ja dhe i aprovuar nga Qeveria, ka parashikuar që vlerësimi i BPV-së vjetore sipas qasjes së shpenzimeve të jetë në dispozicion në Shtator, dhe sipas qasjes së prodhimit në Nëntor të vitit 2013. praktikisht akoma ekziston dallimi kohor i BVP me dy qasjet. Një prej objektivave të projektit të binjakëzimit do të jetë vlerësimi dhe publikimi i BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në të njëjtën kohë, në një formë të balancuar; kjo mund të realizohet në vitin 2015.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.2.1.1

Raporti i misionit.

Analizimi i ndryshimeve të ESA 2010 dhe implementimi i tyre në Llogaritë Kombëtare të Kosovës.

Rishikimi i Llogarive Kombëtare vjetore bazuar në ESA 2010

Trajnimi në orar të punës mbi vlerësimin e Llogarive Kombëtare vjetore

Stafi i ASK:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florijs Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florijs.Krap@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Ekspert, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK, me mbështetjen e IPA, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaron që në parim përmirësimet dhe rritja e mbulueshmërisë së Llogarive Kombëtare vjetore duhet të jenë prioritet për ASK-në. Kalkulimi i BPV duke përdorur qasjen sipas prodhimit dhe shpenzimeve është me rëndësi të veçantë në këtë drejtim.

Aktivitetet e pritura janë:

- Rishikimi i llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve për periudhën 2008-2012 bazuar në ESA 2010
- Përkrahja për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve bazuar në ESA 2010 për periudhën 2013

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas mostrës
- Rekomandimet për aktivitetet e më tej për të siguruar arritjen e qëllimeve të rishikimit të llogarive kombëtare sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve

Aneksi 1. Programi, 1-5 - Shtator 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		09:30	Aktivitetet që janë zhvilluar që nga misioni i fundit

		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Analizimi i implementimit të ESA 2010 në llogaritë kombëtare për periudhën 2008-2010
		12:00	Dreka
		13:10	Analizimi i implementimit të ESA 2010 në llogaritë kombëtare për periudhën 2008-2010 - vazhdim
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Analizimi i implementimit të ESA 2010 në llogaritë kombëtare për periudhën 2008-2010 - vazhdim
		16:30	Konkluzionet preliminare
2	ASK	09:00-12.00	Analizimi i burimit të të dhënave për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për 2013
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Përpilimi i BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 – çmime aktuale Konsultime dhe trajnim në vendin e punës
3	ASK	09:00-12.00	Përpilimi i BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 – çmime aktuale – vazhdim
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Përpilimi i BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 – çmime aktuale – vazhdim
4	ASK	09:00-12.00	Përpilimi i BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 – çmime konstante Konsultime dhe trajnime në vendin e punës
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Përpilimi i BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve për vitin 2013 – çmime konstante Konsultime dhe trajnime në vendin e punës
5	ASK	09:00	Diskutime në lidhje me problemet kryesore të përpilimit të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Rekomandimet për aktivitet e radhës
		12:00	Dreka
		13:15-17.00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike,

Xhevdie Fetahu, shef i Departamentit të Llogarive Kombëtare

Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti,
Have Kryeziu, Besim Mehmeti

Ekipi i RTA :

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, RTA Asistente